



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC

Nr. 118/ prot.  
112

Pogradec, më 05.09. 2023

VENDIM

Nr. 66 DATË 05.09, 2023

**PËR CAKTIMIN E VËNDEVE PËR AFISHIMIN E MATERIALEVE  
PROPAGANDISTIKE GJATË FUSHATËS ELEKTORIALE**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, nenit 79 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 3 për “Caktimin e vendeve për afishimin e materialeve propagandistike”, të Udhëzimit Nr. 6 datë 23.03.2021 “Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”

**VENDOSA:**

1. Subjektet zgjedhore të afishojnë materialet e tyre propagandistike në një largësi deri në 5 (pesë) metra nga zyrat e tyre zgjedhore, apo subjekti zgjedhor, dhe jo me parë se 30 (tridhjetë) ditë para datës së zgjedhjeve.
2. Ndalohet afishimi i materialeve propagandistike në: fasadat e godinave të banimit, institucioneve publike apo ambjenteve rrethuese pranë e rreth tyre, brenda zonave rekreative, parqeve, në pemët e qytetit dhe në shtyllat e ndriçimit.
3. Ndalohet afishimi i matetialeve propagandistike në mjete që operojnë në transportin publik.
4. Vendet e caktuara duhet të jenë në mjedise që sigurojnë shikueshmëri publike dhe të kenë hapësirë të mjaftueshme që të gjitha subjektet zgjedhore që marrin pjesë në zgjedhje të mund të paraqesin materialet propagandistike, programet e tyre zgjedhore dhe/ose mesazhet zgjedhore.
5. Subjekteve zgjedhore iu lejohe të afishojnë materialet propagandistike vetëm në vendet e përcaktuara nga Kryetari i Bashkisë, sipas këtij neni, dhe marrin masa për heqjen e tyre me përfundimin e fushatës zgjedhore.
6. Vendi i përcaktuar për afishimin e materialeve propagandistike do të jetë tek ndërtesa e Teatrit të Kukullave, faqja anësore nga ana jugore e ndërtesës .
7. Policia Bashkiake dhe/ose Policia e Shtetit garantojnë zbatimin e përcaktimeve të bëra në këtë Vendim, duke hequr menjëherë çdo material propagandues të subjekteve zgjedhore nga vendet jashtë përcaktimeve të bëra në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij Vendimi.
8. Vendimi bëhet publik në faqen e internetit të Bashkisë menjëherë pas miratimit.
9. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

